

VENDIM
Nr.1057, datë 30.9.2009

**PËR PËRCAKTIMIN E KOMPETENCAVE TË MINISTRIT TË SHTETIT PËR
REFORMAT DHE MARRËDHËNIET ME KUVENDIN NË FUSHËN
E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

(Ndryshuar me VKM nr. 39, datë 27.1.2010)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 7 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Ushtimin nga Ministri i Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin të kompetencave të ministrit përgjegjës në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr.9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” *si dhe në ligjin nr.8530, datë 23.9.1999 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha